



REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL



Duke marrë në konsideratë se një gjyqësor i pavarur është thelbësor për të dhënë drejtësi në një shoqëri demokratike, për të forcuar epërsinë e sundimit të ligjit, për të mbrojtur liritë individuale, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, veçanërisht të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor dhe të drejtën e çdo personi për të përdorur gjuhën që ai kupton gjatë shqyrtimit të çështjeve gjyqësore në gjykatat e Republikës së Kosovës, të cilat të drejta janë të garantuara nga neni 22 [Zbatimi i drejtëpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Direktiva 2010/64/EU e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës e 20 tetorit të vitit 2010 dhe Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve në Republikën e Kosovës.

Duke njohur rëndësinë dhe nevojën e shërbimit të përkthyesve dhe/apo interpretëve gjyqësor të certifikuar dhe emëruar në Gjykatat e Republikës së Kosovës, për të mundësuar largimin e barrierave gjuhësore për një qasje të njëjtë në drejtësi për personat të cilët nuk janë folës burimor apo të rrjedhshëm të dy gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës ose një gjuhë zyrtare e Republikës së Kosovës dhe një gjuhë e huaj, si dhe nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën, si dhe anasjelltas.

Me qëllim të ushtrimit të profesionit si përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësor të certifikuar dhe emëruar në përputhje me ligjin dhe standardet më të larta etike dhe profesionale dhe krijimin e një shërbimi cilësor, në mbrojtje të interesave të çdo personi pa diskriminim, në procedurë para gjykatave të Republikës së Kosovës.

Për të vendosur dhe zbatuar standardet më të larta të etikës dhe sjelljes profesionale në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e përkthimit dhe interpretimit, që garantojnë ushtrimin e profesionit dhe ofrimin e një shërbimi sa më cilësor.

Duke marrë në konsideratë rregullimin, për procedurat e certifikimit dhe emërimit, kushtet, të drejtat dhe detyrimet për përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësor të certifikuar dhe emëruar në pajtim me nenin 39 paragrafi 3 Ligji Nr. 06/L - 054 Për Gjykatat, neni 211 paragrafi 3 i Kodit Nr.08/L-032 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 07/2023 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet, Shpërblimin dhe Disiplinimin e Përkthyesve dhe Interpretëve Gjyqësorë;

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në mbledhjen e mbajtur më datën 12 qershor 2023,

**Miraton:**

## **KODIN E ETIKËS PËR PËRKTHYES DHE/APO PËRKTHYES DHE INTERPRET GJYQËSOR TË CERTIFIKUAR DHE EMËRUAR**

### **Zbatimi**

Ky kod është i zbatueshëm për çdo përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësor të certifikuar dhe emëruar që kryen shërbime në procedurat gjyqësore në territorin e Republikës së Kosovës.

### **Përkufizimi i termave**

Për qëllimet e këtij Kodi, termat në vijim do t'i kenë këto kuptime:

**Gjuhët zyrtare:** Ato gjuhë që janë përkufizuar në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) me theks të veçantë në nenet 2, 12, 13, 14, 16 dhe 17.

**Përkthyes/e dhe/apo përkthyes dhe interpret/e gjyqësor/e i certifikuar dhe emëruar:** Përkthyesit dhe/apo interpretët gjyqësorë janë profesionistë që janë të kualifikuar për ta përkthyer gjuhën e folur dhe/ose gjuhën e shkruar dhe që janë certifikuar për ta bërë këtë në gjykatat e Kosovës nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për gjuhët specifike.

**Përkthimi konsektiv:** Interpreti përkthen pasi folësi i gjuhës burimore ta ketë kryer të folurit. Përkthyesit e gjuhës së folur mund të përdorin teknika të veçanta të marrjes së shënimeve për të ndihmuar në përkthimin e fjalive të gjata.

**Zotësia ndërkulturore:** Vetëdija profesionale dhe të kuptuarit e faktorëve kulturorë, duke përfshirë sjelljen dhe gjestet, tonin e zërit, vlerat, rolet, institucionet si dhe dallimet dhe ngjashmëritë gjuhësore, por duke mos u kufizuar me to.

**Përkthimi simultan:** Interpreti e bartë mesazhin nga gjuha burimore në gjuhën e synuar dhe anasjelltas.

**Përkthimi gjatë të lexuarit:** Kjo metodë kërkohet për përkthimin me gojë të dokumenteve të shkruara sipas rastit. Dokumenti në gjuhën burimore përkthehet me gojë.

**Pëshpëritja:** Përkthim simultan, pa përdorimin e kabinave të përkthimit, i cili zakonisht u ofrohet më së shumti tre personave.

## **Parimet e përgjithshme në ushtrimin e profesionit**

Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar gjatë ushtrimit të profesionit të tij udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë dhe përgjegjësisë, detyrimit për t'iu përgjigjur kërkesave, profesionalizmit, të etikës, të integritetit, besnikërisë ndaj tekstit burimor, paanshmërisë dhe parandalimit të konfliktit të interesit, konfidencialitetit të të dhënave, si dhe të mosdiskriminimit e të trajtimit të barabartë duke zbatuar standardet më të larta etike dhe profesionale.

## **Parimi ligjshmërisë dhe përgjegjësisë**

Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar ushtron të gjitha detyrat e tij në bazë të Kushtetutës, instrumenteve të aplikueshme ndërkombëtare, legjislacionit në fuqi dhe aktet e miratuara në Këshill dhe është përgjegjës për pasojat e veprimeve dhe mosveprimeve të tij.

## **Parimi i detyrimit për t'iu përgjigjur kërkesave, efikasitetit dhe efektshmërisë**

Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar ushtron të gjitha detyrat pa vonesë dhe duhet të siguroj zbatimin efikas dhe të efektshëm për përmbushjen e detyrave për të cilat është angazhuar.

## **Parimi i profesionalizmit**

1. Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar:

1.1. ushtron të gjitha detyrat dhe funksionet e tij duke garantuar përkushtim dhe gatishmëri për të kryer një përkthim / interpretim cilësor, të përgjegjshëm dhe profesional duke përdorur njohuritë dhe aftësitë e tij profesionale dhe nuk merr përsipër kryerjen e detyrave që nuk ka profesionalizmin për t'i kryer;

1.2. kryen përkthimin brenda afatit të përcaktuar ose brenda një afati të arsyeshëm kur afati nuk është i përcaktuar dhe njofton për çdo shkak apo rrethanë që mund të cenoj kryerjen e përkthimit brenda afatit të paraparë.

## **Parimi i etikës dhe integritetit**

1. Për të garantuar respektimin e parimit të etikës dhe integritetit, përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar:

1.1. ushtron veprimtarinë dhe profesionin në mënyrë të pavarur duke shmangur çfarëdo lloj forme interesi personal apo financiar që mund të ndikojë në kryerjen e detyrave dhe shmang çdo sjellje të pahijshme e të papërshtatshme etike dhe morale që cenon besimin e publikut;

- 1.2. zbaton standardet më të larta të integritetit, sjelljes etike, morale dhe profesionale, duke përfshirë edhe sjelljen kur ai nuk është duke ushtruar veprimtarinë dhe nuk kërkon ose pranon, dhurata, favore, pritje ose çfarëdo përfitim tjetër dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit me përjashtim të pagesës së përcaktuar me rregulloren në fuqi;
- 1.3. shmang përdorimin e paligjshëm të statusit të përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretit gjyqësor të certifikuar dhe emëruar, me qëllim krijimin e përfitimeve dhe favoreve për vete ose për të tjerët, si dhe shmang çdo sjellje apo veprim që rrit në mënyrë të pajustificuar masën e shpërblimit për kryerjen e përkthimit/interpretimit.

### **Parimi i besnikërisë ndaj tekstit burimor**

1. Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar për të garantuar respektimin e parimit të besnikërisë ndaj tekstit burimor:

- 1.1. të gjitha fjalët duhet të përkthehen besnikërisht në gjuhën e synuar, duke i ruajtur të gjitha elementet e mesazhit origjinal dhe duke i përdorur format sintaksore dhe semantike të gjuhës së synuar. Përkthimi duhet të tingëllojë i natyrshëm në gjuhën e synuar, ndërsa mesazhi origjinal nuk duhet të shtrembërohet përmes shtimeve apo heqjeve, shpjegimeve apo parafrazimeve;
- 1.2. të gjitha elementet e pa thëna, siç janë pauzat, gabimet, fillimet e gabueshme dhe/ose përsëritjet duhet të barten në gjuhën e synuar. Fjalët e gjuhëve të huaja të cilat nuk kanë përkthim adekuat në gjuhën shqipe, duhet të ruhen, siç duhet të ruhen edhe shprehjet që kanë të bëjnë me kulturën dhe që nuk kanë ndonjë shprehje ekuivalente të drejtpërdrejtë në gjuhën e synuar ose që mund të kenë më shumë se një kuptim;
- 1.3. interpreti gjyqësor përdor përkthimin konsektiv, simultan, pëshpëritës, gjatë të lexuarit sipas kërkesave për komunikim optimal ndërkulturor në kontekstin juridik;
- 1.4. përkthen çdo fjalë dhe shprehje, duke përfshirë edhe shprehjet vulgare, nënçmuese dhe fyerjet;
- 1.5. njofton menjëherë çdo pasaktësi në përkthim duke përdorur shprehjen “Përkthyesi/interpreti gjyqësor njofton korrigjimin e një pasaktësie” dhe më pas korrigjon pasaktësinë si dhe njofton dhe kërkon përsëritje, riformulim ose shpjegim menjëherë sapo konstaton vështirësi ose paqartësi në të kuptuarit e tekstit ose mesazhit e përçuar duke përdorur shprehjen “Përkthyesi/interpreti gjyqësor kërkon përsëritjen/riformulim/shpjegimin e ...”.

### **Parimi i paanshmërisë dhe parandalimi i konfliktit të interesit**

1. Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar ushtron aktivitetin e tij në pajtim me legjislacionin përkatës për parandalimin e konfliktit të interesit.
2. Gjatë kryerjes së detyrës, përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar, kur ka dijeni për ekzistimin e konfliktit të interesit është i detyruar që:
  - 2.1. të identifikoj nëse ka një konflikt të mundshëm të interesit; dhe,
  - 2.2. të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të shmangur vet konfliktin e interesit.
3. Gjatë kryerjes së detyrës, përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar, është i obliguar:
  - 3.1. të ruaj paanshmërinë ndërmjet palëve apo personave të tjerë gjatë përkthimit dhe shmang çdo lloj shprehje apo veprimi i cili mund të ndikoj në qëndrimin e lexuesve të tekstit të përkthyer apo të dëgjuesve;
  - 3.2. të mos paragjykojë dhe të shmangë çdo sjellje, shprehje mendimi, koment apo veprim, të kërkuar ose jo, që mund të interpretohet si shprehje e njëanshmërisë së tij ndaj autorit të tekstit burimor, lexuesve të tekstit që përkthen, si dhe dëgjuesve;
  - 3.3. që të mos merr përsipër kryerjen e një përkthimi ose heq dorë prej tij në rast se nuk mund të kryej përkthimin në mënyrë të paanshme për shkak të pikëpamjeve personale.

### **Parimi i konfidencialitetit të të dhënave**

1. Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësorë i certifikuar dhe emëruar ruan sekretin profesional dhe konfidencialitetin e të dhënave për të cilat është vënë në dijeni nga faktet, rrethanat ose dokumentet e vëna në dispozicion për përkthim, përveç kur dhënia e këtij informacioni është detyrim ligjor.
2. Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar merr të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen dhe sigurimin e të gjithë informacionit apo dokumentacionit të dhënë nga palet gjatë dhe pas kryerjes së detyrave të tij.
3. Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar u nënshtrohen kushteve të Deklarates së Pranimit që e nënshkruajnë në kohën e certifikimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

## **Parimi i mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë**

Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar e kryen profesionin e tij në pajtim me parimin e mosdiskriminimit duke shmangur çdo formë të diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, bindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të mos diskriminimit të palëve.

## **Standardet e sjelljes profesionale**

1. Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar shmang çdo sjellje të papërshtatshme, që bie në kundërshtim me këtë Kod, legjislacionin në fuqi dhe aktet e miratuara në Këshill si edhe ato veprime që mund të dëmtojnë imazhin e gjyqësorit ose të hedhin dyshime mbi figurën e tij profesionale dhe morale.

2. Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij zbaton rregullat e sjelljes, si më poshtë:

- 2.1. sillet në çdo kohë në mënyrë të sjellshme dhe dinjitoze duke mbajtur një qëndrim korrekt dhe profesional;
- 2.2. mban veshje formale dhe të përshtatshme;
- 2.3. shmang kryerjen e veprimeve ose gjesteve të pahijshme, përçmuese dhe ofenduese që ndikojnë negativisht në perceptimin e publikut.

3. Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar është i obliguar që të respektoj rregullat në gjykatë dhe të mbajë kartelën identifikuese në vend të dukshëm.

## **Marrëdhënia me gjykatën, palet dhe koleget**

1. Në marrëdhënien me palet dhe gjykatën, përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësor i certifikuar dhe emëruar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin për punën e kryer në përputhje me kompensimin e miratuar në rregullore përkatëse.

2. Detyrimet e përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretit gjyqësor të certifikuar dhe emëruar ndaj palëve dhe gjykatës, janë si në vijim:

- 2.1. të informojë në mënyrë të plotë e të saktë mbi njohuritë dhe aftësitë e tij profesionale;
- 2.2. të respektojë solemnitetin e gjykimit;
- 2.3. t'i përgjigjet në mënyrë të plotë dhe të arsyetuar kërkesave që i paraqiten.

3. Marrëdhëniet e përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretit gjyqësor të certifikuar dhe emëruar me gjykatën dhe palën, mbështeten në parimet e bashkëpunimit, ndershmërisë dhe solidaritetit profesional dhe nuk bëjnë asnjë veprim apo mosveprim që nuk është në përputhje me reputacionin e profesionit për të marrë shërbimin e kolegut të tij ose që përbën shkak për konkurrencë të pandershme.

### Shkelje disiplinore

Moszbatimi ose shkelja, me veprime ose mosveprime, i parimeve të etikës dhe të sjelljes profesionale, të përcaktuara në këtë Kod, nëse nuk përbën vepër penale, përbën shkelje disiplinore dhe merren masat disiplinore sipas procedurës së përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe aktet e miratuar nga Këshilli.

### Shtojca

1. Shtojca që i është bashkangjitur këtij Kodi është pjesë përbërse e tij:

1.1. Shtojca 1: Deklarata e Pranimiit.

Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: 21 . 06 . 2023



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

### Deklarta e Pranimit

Unë, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, i certifikuar nga  
(emri, emri i babës dhe mbiemri) (përkthyes / interpret gjyqësor i certifikuar dhe emëruar),

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me numër certifikate: \_\_\_\_\_, me datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_ dhe me numër personal \_\_\_\_\_, pranoj se, në momentin e marrjes së Certifikatës, më është siguruar një kopje e “Kodit të Etikës për Përkthyes dhe/apo Përkthyes dhe Interpret Gjyqësor të Certifikuar dhe Emëruar ” dhe se e kam lexuar dhe e kuptoj fushëveprimin e plotë të Kodit dhe zbatimin e tij për punën time si përkthyes/e dhe/apo përkthyes/e dhe interpret/e gjyqësor/e i/e certifikuar dhe emëruar. Përveç kësaj, unë e pranoj se e kuptoj se do të mbaj përgjegjësi për të zbatuar me përpikmëri standardet më të larta etike dhe profesionale të të gjitha parimeve që i përmban Kodi: ligjshmërisë dhe përgjegjësisë, detyrimit për t’iu përgjigjur kërkesave, efikasitetit dhe efektshmerisë, profesionalizmit, të etikës dhe i integritetit, besnikërisë ndaj tekstit burimor, paanshmërisë dhe parandalimit të konfliktit të interesit, konfidencialitetit të dhënave, si dhe të mosdiskriminimit e të trajtimit të barabartë dhe se për shkeljen e cilësdo parim dhe rregull do t’i nënshtrohem procedurave ligjore dhe disiplinore, duke përfshirë revokimin e certifikates time dhe ndalimin e aftësisë sime për të marrë dhe për të pranuar detyra si përkthyes/e dhe/apo përkthyes/e dhe interpret/e gjyqësor/e i/e certifikuar dhe emëruar .

Kjo deklaratë e pranimit do të ruhet si pjesë e dosjes së certifikimit tim në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe do të jetë e vlefshme edhe nëse Kodi përditësohet apo ndryshohet në çfarëdo mënyre.

---

(Nënshkrimi i përkthyesit/ interpretit të certifikuar)